

Universiteti Bujqesor Tirane

Titulli i Projektit : “Monitorimi i midhikultures dhe shtreses
jetesore ne liqenin e Butrintit”

Finacuar nga AKTI , periudha e monitorimit viti 2010 dhe 2012

Stafi i projektit :

Koordinatorë : Prof.Ass.Dr. Jerina Kolutari, Dr. Eqerem Kapedani,
Dr. Enkejda Buda, Prof.Dr.Enkelejda Sallaku, Edmond Gorenca.



Hyrje

- Studimi është vazhdimi i traditës së studimeve të Institutit të Kërkimeve të Peshkimit.
- Me ndjekjen e dinamikës së ekosistemit të liqenit të Butrintit arrihet të gjykohet mbi tendencat e tij në aspektet e produktivitetit të midhjes (*Mytilus galloprovincialis*) që është një nga organizmat kryesorë dhe më simbolik të biodiversitetit të këtij liqeni.
- Ky monitorim ndërmjet analizimit të komponenteve hidrokimike të kampioneve të ujit të marra në lagune në periudha tre mujore, synon të studiojë ndikimin e këtyre komponenteve në prodhimtarinë dhe cilësinë e midhjes.
- Monitorimi i cilësisë së ujit dhe midhjes ndikon në ruajtjen e niveleve të sigurisë së konsumatorëve të saj të cilët sa vijnë e shtohen në vendin tonë.
- Të dhënat e nxjerra nga ky monitorim shërbejnë si udhëzues për kultivuesit që merren me rritjen e midhjes në Liqen.

Metodologjia



- Per monitorimin e liqenit te Butrintit eshte bere vleresimi 3 shkallesh :
 - a. Parametrat fiziko-kimike
 - b. Treguesit e midhikultures
 - c. Treguesi hidrobiologjik
- Aparaturat e perdorura multiparameter,
- Matjet jane kryer cdo muaj ne periudhen, korrik – dhjetor 2010 dhe korrik - dhjetor 2012.


“Monitorimi i midhikultures dhe shtreses jetesore ne liqenin e Butrintit” (AKTI)

Rezultate

Parametrat fiziko -kimike


Muajt	Thellesia (m)	Klorof.a	Temp. (°C)	Kripsh. (‰)	pH	O ₂ %	O ₂ mg/l	NO ₂ ⁻	PO ₄ ³⁻
Tetor (2010)	1	1.89	16.9	19.4	8.37	112.2	8.6	0.011	0.16
	3	1.1	18.8	24.7	8.2	75.3	6.25		
	5	0	19.1	30.4	7.9	64	4.9		
Janar (2012)	1	1.35	10.1	15.8	7.62	99.6	9.98	0.005	0.03
	3	0	17.3	30.2	7.5	80.3	7.68		
	5	0	18.5	23.4	7.4	23.4	2.3		
Prill (2012)	1	0.785	20.4	21.7	7.79	111.9	9.05	0.018	0.065
	3	0	19.9	23.7	7.7	91.1	8.15		
	5	0	18.3	26.7	7.4	85.5	7.42		
Qershor (2012)	1	1.85	26	26.8	8.06	96	7.8	0.07	0.027
	3	0	26	27	7.9	84	5.7		
	5	0	23.4	32.8	7.69	73	4.7		
Mesatarja		0.5813	19.56	25.217	7.794	83.0	6.8775	0.026	0.0705
Min		0	10.1	15.8	7.4	23.4	2.3	0.005	0.027
Max		1.89	26	32.8	8.37	112.2	9.98	0.07	0.16
Deviacioni standart		0.774	4.303	4.8415	0.307	23.903	2.176457	0.029811	0.06211
Koeficjenti I variacionit		1.3315	0.22	0.192	0.039	0.2879	0.316461	1.146558	0.880995

Rezultate



Per periudhen shtator-tetor 2010 , mbizoteroni individet e midhjes me gjatesi 4cm, ndersa rrezet me te larte te mishit e arriten midhjet e grup gjatesise 7,0-7,5 cm .

Rezultate



Infestimi me Karaul rezultoi ne masen 15%, per periudhen shator-tetor 2010.

Rritje te tendences se lendes organike si dhe epibionteve ne guaskat e midhjeve me Belanus, Serpuloide etj

Keta tregues ulin cilesine e midhjeve dhe ndikojne ne rrezen e saj qe ulet 10-20% kundrejt normales.

Rezultate

Situata hidrologjike, fiziko-kimike e liqenit ka pesuar nje krize katastrofike, biologjike per shkak te temperaturave shume te larta e stanjacionit te ujrave, ne periudhen qershor-korrik, 2012.

Ngarkesa e larte me epibionte per arsye te situates shume kritike ne liqen.

Midhja predominuese ka qene 16-18 muajshe me gjatesi 6.5 cm dhe rreth 20% e tyre luhaten ne permasat 19.5 - 35.7%.



Rezultate

- Permiresimi i treguesve hidrokimike po vjen me ritem te ngadalte pasi oksigjeni eshte nen kufijte e ngopjes se plote, nga 100% qe duhet te ishte ne kete periudhe. Kjo, pasi ka akumuluar konsum te madh te tij nga oksidimi i lendes pezull dhe sasia e madhe e nitriteve.
- Shqetesim mbetet saliniteti i larte ne izobatet 3 -5 m, ne kufijte 29,4 - 33,4% me shume nga mesatarja shumevjecare. Kjo situatë spjegohet me vazhdimin e stanjacionit te theksuar te ujrave ne liqen ne mungese te theksuar komunikimi me detin, dhe thatesiren e madhe (mungesa e rreshjeve).
- Prezenca per nje kohe te gjate e salinitetit ne keto limite ka lejuar zhvillimin masiv te acideve (patatja e detit) qe kerkon nje gjendje stenohaline.



Rezultate

- Ne zonen e Manastirit midhja e kultivuar e mbuluar me fare ka filluar procesin e ngordhjes.
- Vihen re kater shtime intensive ku predominojne shtimet e prodhuesve ne muajt : Nentor, Dhjetor, Shkurt e Mars.
- Situata meterologjike eshte e disfavorshme.



Rekomandime

-Hapja e kanalit të komunikimit të liqenit të Butrinitit në grykderdhjen e tij deri në 7 metra që t'i përgjigjet ujëkëmbimit të plotë sidomos pas qershorit në mënyrë që të eleminohet në maksimum stanjacioni i ujërave.

-Në muajt e nxehtë komandimi i devijimit të Bistricës të kryhet në maksimumin e kapacitetit të kanalit devijues,

-Të kontrollohet periodikisht zbatimi i teknologjisë së kultivimit të midhjeve për të evituar ngarkesat me epibionte që shkakton pasoja dhe në impiante që zbatojnë masat teknologjike.

-Të zbatohet teknologjia e vendosjes së impianteve (vargjeve) për mbledhjen e farës së midhjes, sidomos të asaj të dhjetorit, për të garantuar një prodhim të qëndrueshëm.

Rekomandime

- Monitorimi permanent i këtij liqeni kaq të rëndësishëm në aspektin ekonomik, të biodiversitetit, ekoturizmit etj. për të prognozuar masat shfrytëzuese e menaxhuese të këtij ekosistemi për të luftuar me të gjitha mënyrat tendencat e eutrofizimit.
- -Monitorimi duhet të vazhdojë me aspektet hidrokimike në liqenin e Butrintit, ato të rritjes së midhjes siç dhe populacionet iktike siç po veprohet dhe nga studimet mesdhetare në këto ekosisteme.
- Laboratori i Akuakultures dhe Peshkimit, Universiteti Bujqesor , Tirane, ka infrastrukturen dhe kapacitetet e nevojshme për monitorimin e liqenit të Butrintit në të gjitha stinet. Kështu i rekomandohet Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit të kryejë propozimin për rifutjen në ligj të monitorimit të liqenit nga ky Institucion.

Faleminderit !

